



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E INSTALACIONIT**  
**"EC ME MUA"**

- I. MIRATOHET Vendimi për vendosjen e instalacionit "Ec me mua", realizuar nga fëmijët e SOS Fshatit në Kryeqytet.
- II. Lokacioni për vendosjen e instalacionit "Ec me mua", caktohet në Parkun e Qytetit, i cili shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 06559-0, Zona Kadastrale Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së këtij instalacioni.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit me pozicionimin e instalacionit, dhe projekti i instalacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Parqeve, dhe drejtoritë tjera kompetente.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-353/02-215739/23, më 03.11.2023**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Pëllumb Bajcinovci**



## ARSYETIM

### I Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit "Ec me mua"

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve i është drejtuar Komunës me një kërkesë për realizimin e një instalacioni i cili ka të bëjë me fëmijët e SOS Fshatit, dhe kërkesën e tyre e kanë arsyetuar si në vijim: Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar. Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë vepron nga viti 1999 dhe deri tani është përkujdesur për mbi 1000 fëmijë të braktisur, pa përkujdesje prindërore dhe në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror. Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, aktualisht ofron strehim, përkujdesje, edukim dhe përkrahje për afër 600 fëmijë përmes 3 Programeve:

- Kujdesi alternativ për fëmijë pa kujdes prindëror - aktualisht përmes 7 SOS Familjeve ofron përkujdesje për 38 fëmijë të braktisur dhe fëmijë pa përkujdesje prindërore të moshës 0 -18 vjeçar
- Programi i gjysëpavarësimit - aktualisht përkrahë 14 të rinjë pa përkujdesje prindërore të moshës mbi 19 vjeç
- Programi i Fuqizimit të Familjes - ofron shërbime të integruara psikologjike dhe sociale në 3 lokacione të Kosovës dhe aktualisht përkrahë mbi 600 fëmijë dhe të rinjë në rrezik të braktisjes dhe familjet e tyre.

Këtë vit së bashku me Studio URA, përfaqësuar nga artistja Laura Sllamniku Kryeziu, fëmijët e programeve të SOS Fshatit kanë punuar instalacionin të cilin e kanë quajtur EC ME MUA, instalacion ky i cili përmes shputave të këmbëve të tyre përçon një mesazh të fortë - TË JEMI PRANË FËMIJËVE DHE TË ECIM SË BASHKU.

I gjithë koncepti i projektit EC ME MUA, ka të bëjë me përçarjen e mesazhit për përkrahjen, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin tonë në lidhje me fëmijët pa përkujdesje prindërore. Gjithashtu puna në realizimin e projektit nënkupton, kyqje, socializimi e njohjen me teknikat e realizimit të qeramikës!

Për fëmijët që realizuan qindra palë shputa dhe në secilën shputë u gravua, u pikturua apo u transmetua ajo çfarë ate pelqejnë, duan e ndjejnë, dhe që e gjithë puna të paraqitej në një vepër çfarë po synojmë fillimisht ka ndikimin psikologjik si nga ana e vetëvlërësimit, vetëbesimit dhe ndjenja e një arritjeje suksesi për fëmijët. Në mënyre simbolike shputat në projektin "EC ME MUA" prezentojnë gjurmët dhe hapat e ardhshëm që gjithsecili fëmijë do të marrë në jetë ku thirrja "EC ME MUA" na fton në sensibilizim dhe ndërgjegjësimin tonë për këta fëmijë.

Me vendosjen e shputave ne formën e Spirales dërgojmë mesazhin të një shpreseje për një rrugëtim i cili do të duhej të jetë një fillim rruge dhe të ketë vazhdimësinë konstate, siq e simbolizon forma e Spirales.

Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së SOS Fshatit nga Komuna, instalacioni në fjalë është propozuar të vendoset në Parkun e Qytetit.

Bashkëngjitur:

- Ortofoto e lokacionit me pozicionimin e instalacionit;
- Projekti i instalacionit.